## Llojet e Çështjeve:

- ÇESHTJE FAMILJARE
- MOSMARRËVESHJE NË PUNË
- REGJISTRIM CIVIL
- SIGURIME SHOQËRORE
- PENSION
- PËRKRAHJE SOCIALE
- TË DREJTAT E NJERIUT

## Parimet themelore të Ndihmës Juridike

***Ndihma juridike bazohet në parimet e:***

- Barazisë së të drejtave për individët që përfitojnë ndihmë juridike;
- Profesionalizmit të atyre që japin ndihmën juridike;
- Cilësisë të shërbimit të ndihmës juridike; E ruajtjes së konfidencialitetit;



# KENI NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE?

**SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË**
dhe
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHE**
mbështetur
nga **UNDP**

KANË HAPUR
**ZYREN E NDIHMËS JURIDIKE PER INDIVIDËT NË NEVOJË NË RRETHIN GJYQËSOR LEZHË**

**Presim telefonata dhe klientë:**
**E HËNË – E ENJTE**
**9:30 – 14:30**

**Tel: 069 29 99 770 / 069 20 93 731**
**+355 2152774/106**

**E-mail: tlas@tlas.org.al**
**Web: portal.tlas.org.al**

www.tlas.org.al

Empowered lives.
Resilient nations.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata e Lezhës

## Çfarë kuptojmë me Ndihmë Juridike

Me Ndihmë Juridike kuptojmë ofrimin e shërbimit ligjor falas për individët në pamundësi financiare për të zgjidhur dhe realizuar të drejtat e tyre.

## Cilat janë format e Ndihmës Juridike që do të ofrohen nga ky projekt?

### *1. Ndihma Juridike parësore përfshin:*

- Informacionin për sistemin ligjor dhe aktet normative në fuqi;
- Për të drejtat e detyrimet e subjekteve të ligjit;
- Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit në proçeset gjyqësore, administrative etj.
- Për hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.
- Shërbim klinik dhe Law Line për klientët që mbasi këshillohen dhe përgatiten me dokumentat përkatëse ligjore, mund të vet-përfaqësohen në administratën publike apo gjykatë.
- Shërbim Ligjor Falas përmes internetit
- Çdo qytetar mund të marrë informacion juridik dhe modele te gatshme (padish etj), për çeshtje te ndryshme, nëpërmjet portalit të TLAS.

### *2. Ndihma Juridike dytësore përfshin:*

- Këshillimin, përfaqësimin në proceset gjyqësore, civile dhe administrative;
- Çeshtjet qe do të trajtohen me prioritet për përfaqësimin në gjykatë do t'i perkasin kryesisht familjeve ekstremisht të varfëra:
  - Çështjet familjare.
  - Çështjet e regjistrimit civil.
  - Çështjet që lidhen me të drejtat ekonomike dhe sociale.

### *3. Ndihma juridike nëpërmjet edukimit ligjor të publikut:*

- Përmes publikimeve; informacion ligjor dhe shpërndarje e fletëpalosjeve.
- Fushatave televizive, në mediane shkruar dhe ate sociale; prezantim i projektit në televizionet lokale dhe median sociale te TLAS në facebook.
- Aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese në komunitet nga grupi i Studentëve të Fakultetit Juridik;
- Aktivitetet Street Law.

***Ky projekt ka për fokus kryesor dhënien e ndihmës juridike parësore. Në raste të caktuara prioritare, mund të ofrohet edhe ndihmë dytësore.***

## Cilët persona do të përfitojnë Ndihmë Juridike?

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët kanë nevojë për Ndihmë Juridike në çështjet civile ose administrative dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar. Në këtë rast, personi duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to, si:

- Të miturit dhe jetimët.
- Gratë e dhunuara dhe personat me aftësi të kufizuar.
- Minoritetet etnike, seksuale.
- Të moshuarit, etj.

## Ku do të kontaktojmë Avokatin e Ndihmës Juridike?

Zyra e ndihmës juridike ndodhet në gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, në katin e parë.

**TLAS PORTAL** portal.tlas.org.al

